



Pro/Strat

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 20438 prot.

Lezhë, më: 30.12. 2024

NJOFTIM

**“PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME HEQJEN NGA FONDI
PYJOR KOMBËTAR NË EKONOMINË PYJORE “MALI I RRENCIT”**

Bashkia Lezhë, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetqëverisjen vendore”, në ligjin Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, në VKM 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, në ligjin 57/2020 “Për Pyjet”, në Projekt Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Lezhë nr 20436 prot, datë 30/12 2024 “Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave, për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion: Kompleks turistik, Resort me suita 1, 2, 3, 4 dhe 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë nga shoqëria **PRINCE ADRIATIK RESORT sh.p.k** dhe **PRINCE JUNIOR sh.p.k**” dhe në Projekt Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Lezhë nr 20437 prot, datë 30/12/2024 “Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave, për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore në pronësi private, për ndërtim objekti me funksion: Kompleks banimi dhe shërbimi 5 kate mbi tokë dhe 1, 2 kate nën tokë nga shoqëria **JUNIK sh.p.k**”, Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Lezhë ka bërë vlerësimin e sipërfaqes pyjore private që hiqet nga fondi pyjor kombëtar.

Në vijim të procesit të konsultimit me publikun, ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjesën publike, ditën e martë, datë **21.01.2025, ora 10:00**, në ambjentet e Qendrës Kulturore të **Fëmijëve “Gjergj Lacaj” Lezhë**. Gjatë takimit të dëgjesës publike do bëhet prezantimi i dokumentave të hartuara nga Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave me qëllim arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm, shfrytëzim të burimeve pyjore dhe plotësimin e nevojave të sipërmarrjes publike.

Ju mirëpresim për të ndarë mendimet tuaja !

KRYETARI
Pjerin NDREU

